

Vendim nr. 244, datë 15.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Ilir Toska, Anëtar

Genti Ibrahimimi, Anëtar

në datën 15.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (GJ) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

OBJEKTI: Shfuqizimi i neneve 5, pika 2 dhe 6 të ligjit nr. 9381, datë 28.04.2005 “Për kompensimin e burgimit të padrejtë”, në pjesën ku vendoset kriteri tavan për dëmshpërblimin e paraburgimit, burgimin dhe arrestin në shtëpi, në mënyrë të padrejtë, respektivisht në 3.000 (tre mijë) lekë, 2.000 (dy mijë) lekë dhe 1.000 (një mijë) lekë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 134, shkronja “dh” dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 28.08.2014 ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të një shtetasi për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Gjatë hetimit dhe gjykimit, ndaj tij është caktuar masa e sigurimit “Arresti në burg” për periudhën 29.08.2014–15.09.2014, e cila më pas është zëvendësuar me masën “Arresti në shtëpi” deri në datën 24.04.2015. Me vendimin e datës 19.02.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka deklaruar fajtor sipas akuzës, ndërsa Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin e datës 13.03.2025, e ka deklaruar të pafajshëm.

2. Pas marrjes së vendimit të pafajësisë, ai ka ngritur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (*gjykata referuese*), të regjistruar në datën 24.12.2025, me objekt kompensimin për burgim të padrejtë (18 ditë arrest në burg dhe 221 ditë arrest në shtëpi), bazuar në nenet 268 dhe 269 të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjin nr. 9381, datë 28.04.2005 “Për kompensimin e burgimit të padrejtë” (*Ligji për Kompensimin e Burgimit*).

3. Në seancën gjyqësore të datës 03.04.2026, gjykata referuese ka vendosur pezullimin e gjykimit dhe ka referuar çështjen në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të pikës 2 të nenit 5 dhe nenit 6 të Ligjit për Kompensimin e Burgimit për pjesën që ka caktuar masën tavan për dëmshpërblimin e burgimit, arrestit në burg dhe arrestit në shtëpi të padrejtë. Çështja është regjistruar në datën 02.06.2026.

II

Pretendimet e gjykatës referuese

4. Gjykata referuese ka pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se dispozitat ligjore të kundërshtuara cenojnë të drejtën kushtetuese për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim në përputhje me ligjin, pasi kufijtë maksimalë të dëmshpërblimit të parashikuar për burgimin, paraburgimin dhe arrestin në shtëpi (përkatësisht deri në 2.000 lekë për çdo ditë burgimi, jo më shumë se 60.000 lekë në muaj; deri në 3.000 lekë për çdo ditë paraburgimi, jo më shumë se 90.000 lekë në muaj; 1.000 lekë për çdo ditë arresti në shtëpi, jo më shumë se 30.000 lekë në muaj) janë joproporционаle me dëmin e shkaktuar dhe nuk pasqyrojnë zhvillimin shoqëror e ekonomik të vendit, duke pasur parasysh edhe pagën minimale prej 50.000 lekësh në muaj, të përcaktuar me VKM-në nr. 776, datë 19.12.2025. Sipas saj, e drejta për zhdëmtim përfshin si dëmin pasuror (material), ashtu edhe atë jopasuror (jomaterial). Për më tepër, kufijtë e parashikuar në ligj nuk mundësojnë kompensimin e

plotë të personave që kanë të ardhura mbi pagën mesatare, duke i lënë ata pa një zhdëmtim të drejtë si për dëmin pasuror, ashtu edhe për atë jopasuror.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

5. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me nisjen e një procesi kushtetues. Kërkesa për kontroll incidental rregullohet nga neni 145, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 68 i Ligjit Organik të Gjykatës, të cilat u njohin të drejtën gjyqtarëve që në çdo fazë të gjykimit, kur çmojnë se ligji që lidhet me zgjidhjen e çështjes konkrete vjen në kundërshtim me Kushtetutën, të mos e zbatojnë atë, duke vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatë për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e ligjit.

6. Gjykata ka zhvilluar tri kriteret kumulative për legjitimitimin, sipas të cilave gjykata referuese duhet: (i) të identifikojë ligjin e zbatueshëm dhe të vlerësojë se gjykimi i saj varet drejtpërdrejt nga vendimmarrja e Gjykatës, pra lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe çështjes kushtetuese; (ii) të parashtrojë arsye bindëse për antikushtetutshmërinë e tij, duke iu referuar normave ose parimeve konkrete kushtetuese; (iii) të ketë bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 70, datë 08.06.2026; nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 8, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Kolegji vëren se çështja kushtetuese e parashtruar nga gjykata referuese ka të bëjë me kontrollin e kushtetutshmërisë së neneve 5, pika 2, dhe 6 të Ligjit për Kompensimin e Burgimit. Këto dispozita përcaktojnë masën e kompensimit për privimin e padrejtë nga liria, duke parashikuar se kompensimi caktohet deri në 3.000 lekë për çdo ditë paraburgimi, 2.000 lekë për çdo ditë burgimi dhe deri në 1.000 lekë për çdo ditë arresti në shtëpi.

8. Duke pasur parasysh se gjykimi konkret ka për objekt ekskluzivisht kompensimin e paraburgimit dhe të arrestit në shtëpi të padrejtë, Kolegji çmon se lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet dispozitave të kundërshtuara dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes ekziston vetëm për parashikimet që rregullojnë kompensimin prej 3.000 lekësh për çdo ditë paraburgimi dhe kompensimin e arrestit në shtëpi deri në gjysmën e kompensimit të caktuar për burgimin, të përcaktuara në nenet 5, pika 2 dhe 6 të Ligjit për Kompensimin e Burgimit. Ndërsa, dispozita që përcakton kompensimin prej 2.000 lekësh për çdo ditë burgimi nuk gjen zbatim në çështjen konkrete dhe, për rrjedhojë, nuk ndikon drejtpërdrejt në zgjidhjen e saj. Për këtë pjesë të kërimit, gjykata referuese nuk legjitimohet.

9. Në vijim, Kolegji vëren se kushtetutshmëria e togfjalëshit “3.000 (tre mijë) lekë për një ditë paraburgim”, e parashikuar në nenin 5, pika 2, të Ligjit për Kompensimin e Burgimit, është vlerësuar më parë nga Gjykata mbi bazën e një kërkesë të paraqitur nga një tjetër gjykatë referuese. Me vendimin nr. 70, datë 08.06.2026, ajo ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke çmuar se dispozita e kundërshtuar nuk binte ndesh me nenin 44 të Kushtetutës.

10. Gjykata ka vlerësuar se nuk qëndronte argumenti se masa e kompensimit ishte zhvlerësuar si pasojë e ndryshimit të treguesve ekonomikë, pasi analiza e gjykatës referuese ishte mbështetur në treguesit ekonomikë të vitit 2025, ndërkohë që paraburgimi për të cilin kërkohej kompensimi ishte vuajtur në vitin 2018. Sipas saj, proporcionaliteti i masës së kompensimit duhet të vlerësohet në raport me realitetin ekonomik të periudhës kur ka lindur e drejta për kompensim dhe jo mbi bazën e treguesve të një periudhe disa vite më të vonë. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se treguesit ekonomikë të vitit 2018 nuk kishin pësuar ndryshime të tilla, në raport me periudhën e miratimit të ligjit, sa të çonin në përfundimin se kufiri maksimal prej 3.000 lekësh për një ditë paraburgim kishte humbur funksionin e tij kushtetues. Duke mbajtur në konsideratë edhe modelet krahasuese, Gjykata ka theksuar se kompensimi nuk synon të zëvendësojë të ardhurat individuale të personit të dëmtuar, por të garantojë një zhdëmtim të standardizuar dhe proporcional për cenimin e lirisë personale. Për rrjedhojë, ajo ka çmuar se përcaktimi nga ligjvënësi i një kufiri maksimal kompensimi nuk është, në vetvete, antikushtetues, për sa kohë ruan një raport të arsyeshëm me qëllimin e ligjit dhe nuk e bën të drejtën për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim teorike ose iluzore (*shih vendimin nr. 70, datë 08.06.2026 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson se kërkimi i gjykatës referuese për shfuqizimin e togfjalëshit “3.000 (tre mijë) lekë për një ditë paraburgim”, të parashikuar në nenin 5, pika 2, të Ligjit për Kompensimin e Burgimit, lidhet me kompensimin e paraburgimit të vuajtur në vitin 2015. Në këto rrethana, duke mbajtur në konsideratë arsyetimin e dhënë në vendimin nr. 70, datë 08.06.2026, si dhe faktin se analiza e gjykatës referuese mbështetet në treguesit ekonomikë aktualë dhe jo në ata të periudhës kur ka lindur e drejta për kompensim, Kolegji çmon se pretendimi për papajtueshmërinë e këtij togfjalëshi me të drejtën kushtetuese për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim, të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, është haptazi i pabazuar.

12. Me të njëjtin arsyetim, Kolegji çmon se është haptazi i pabazuar edhe kërkimi për shfuqizimin e togfjalëshit “nuk duhet të jetë më e madhe se një e dyta e shumës së caktuar për burgimin”, të parashikuar në nenin 6 të Ligjit për Kompensimin e Burgimit. Edhe në këtë rast, analiza e gjykatës referuese mbështetet në treguesit ekonomikë dhe socialë të vitit 2025, ndërkohë që e drejta për kompensim lidhet me arrestin në shtëpi të vuajtur rreth dhjetë vjet më parë. Për

rrjedhojë, pretendimi për antikushtetutshmërinë e kësaj dispozite nuk është vlerësuar në raport me realitetin ekonomik të periudhës kur ka lindur e drejta për kompensim, por mbi bazën e treguesve të një periudhe të mëvonshme.

13. Në këtë pikë, Kolegji evidenton se, sikurse edhe Gjykata ka pranuar, neni 44 i Kushtetutës nuk garanton një shumë të caktuar kompensimi, por të drejtën për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim në përputhje me ligjin. Në këtë kuptim, ligjvënësi gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi për të përcaktuar kushtet, kriteret, procedurat dhe masën e kompensimit. Ky diskrecion, megjithatë, nuk është i pakufizuar. Rregullimi ligjor duhet të respektojë thelbin e garancisë kushtetuese, të mbështetet në kritere objektive dhe të arsyeshme, të jetë proporcional me qëllimin e synuar dhe të mos e bëjë të drejtën për zhdëmtim iluzore ose joefektive. Proporcionaliteti i masës së kompensimit duhet të vlerësohet në raport me realitetin ekonomik të periudhës kur ka lindur e drejta për kompensim, i cili nuk synon të zëvendësojë të ardhurat individuale të personit të dëmtuar, por të garantojë një zhdëmtim të standardizuar dhe proporcional për cenimin e lirisë personale (shih vendimin nr. 70, datë 08.06.2026 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Në rastin konkret, mbështetja e analizës në treguesit ekonomikë të kohës së ngritjes së padisë (viti 2025), pothuajse një dekadë pas lindjes të së drejtës për zhdëmtim (vitet 2014-2015), nuk përbën një argument të mjaftueshëm për të vënë në dyshim kushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar. Nga ana tjetër, masa e kompensimit nuk synon të zëvendësojë të ardhurat individuale të personit të dëmtuar, por të garantojë një zhdëmtim të standardizuar dhe proporcional për kufizimin e padrejtë të lirisë personale si pasojë e qëndrimit nën masën e arrestit në shtëpi. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, Kolegji mban në konsideratë edhe faktin se nëse individit i është shkaktuar dëm pasuror në marrëdhëniet e punësimit për shkak të procedimit penal, legjislacioni në fuqi parashikon mjete të tjera juridike për kërkimin dhe shpërblimin e këtij dëmi.

15. Nisur nga kjo analizë, Kolegji vlerëson se gjykata referuese nuk ka paraqitur arsye bindëse dhe të mjaftueshme për antikushtetutshmërinë e dispozitave të kundërshtuara, ndaj për këtë shkak çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31/a, pika 2, shkronja “e” dhe 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.